



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC**

Numri i lëndës: 2024:037185

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05844031

CT.nr.6/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në procedurën jokontestimore për shqyrtimin e trashëgimisë, pas vdekjes së trashëgimlënësit H (M) S ish nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, duke vendosur lidhur me shqyrtimin e trashëgimisë, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës për shqyrtimin e trashëgimisë, më datën 21.06.2024 merr këtë:

**A K T V E N D I M**

Pas të ndjerit H (M) Sish nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, me numër personal ..., i cili ka lindur më data..., ndërsa ka vdekur më data..., pa lënë testament e as kontratë mbi mbajtjen e përjetshme, shtetas i Republikës së Kosovës, SHPALLET për trashëgimtar, në bazë të trashëgimisë e me obligim të kthimit të borxheve eventuale të trashëgimlënësit, deri në lartësinë e vlerës së trashëguar:

- I. Q (H) S, nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, me numër personal ..., përndryshe biri i të ndjerit, shpallet pronar në këtë masë trashëgimore respektivisht në pjesët si në vazhdim: 1/1 pjesë të parcelës me nr. 00303-1 ZK Krushë e Madhe, 1/1 pjesë të parcelës me nr. 00304-1 ZK Krushë e Madhe, 1/1 pjesë të parcelës me nr. 01376-1 ZK Krushë e Madhe, 1/1 pjesë të parcelës me nr. 01376-2 ZK Krushë e Madhe, 1/1 pjesë të parcelës me nr. 01424-0 ZK Krushë e Madhe, 1/1 pjesë të parcelës me nr. 01531-0 ZK Krushë e Madhe, 1/1 pjesë të parcelës me nr. 02047-1 ZK Krushë e Madhe, 1/1 pjesë të parcelës me nr. 02047-2 ZK Krushë e Madhe, 1/1 pjesë të parcelës me nr. 02151-1 ZK Krushë e Madhe, 1/1 pjesë të parcelës me nr. 02151-4 ZK Krushë e Madhe, 1/2 pjesë të parcelës me nr. 00802-0 ZK Krushë e Madhe.
- II. Detyrohet trashëgimtari i shpallur Q (H) S që kësaj gjykate t'ia paguajë taksën gjyqësore për shqyrtimin e trashëgimisë, në shumën prej 150.00 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

## A r s y e t i m

Pranë kësaj gjykate është iniciuar procedura e trashëgimisë pas vdekjes së trashëgimlënës H (M) S ish nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, pasuria e të cilit është përshkruar në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata gjatë procedurës dhe nga shkresat e lëndës ka vërtetuar se i ndjeri ka pasur banimin e fundit në territorin e kompetencës territoriale të kësaj gjykate, se ka vdekur më 30.01.1987, pa lënë testament e as kontratë mbi mbajtjen e përhjetshme, dhe se prej trashëgimtarëve të rendit të parë të trashëgimisë ka lënë trashëgimtarët dhe atë të birin Q.S.

Sipas kësaj çështje juridike gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor lidhur me këtë çështje të trashëgimisë, më datë 14.06.2024, ku trashëgimtari Q.S, ka pranuar që të shpallet trashëgimtarë në pasurinë e të ndjerit në pjesët që i takon sipas ligjit dhe në pjesët që eventualisht dikush prej trashëgimtarëve heq dorë në interes tyre, ndërsa trashëgimtarëve të tjerë nuk ua kanë mohuar të drejtën për trashëgimi.

Andaj, gjykata duke u mbështetur në dispozitat e neneve 12, 119 dhe 135 të Ligjit për Trashëgiminë i Kosovës, si dhe në dispozitat e neneve 125, 128 dhe 162.1 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore, ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
CT.nr.6/2024, më datë 21.06.2024

Bashkëpunëtorja profesionale  
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari  
Avni Berisha

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykat